



KONTROLLI I LARTE I SHETIT
Departamenti i Auditimit të Administrimit të Aseteve,
Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Nr. 529/8 Prot.

Tiranë, më 06/09/2016

V E N D I M

Nr. 99, Datë 06.09.2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË ZYRËN
VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME KUÇOVE "MBI
PROCEDURËN E PRANIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË DOKUMENTACIONIT PËR
REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE
EVIDENTIMIN E TRAJTIMIN LIGJOR TË MBIVENDOSJEVE".

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Sigurimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë, për procedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme dhe evidentimin e trajtimin ligjor të mbivendosjeve”, të ushtruar në ZVRPP Kuçovë për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: ZVRPP Kuçovë, në 2 raste, në ZK. 1699 (Fshati Gegë), ka regjistruar 19 AMTP në përdorim, me sipërfaqe 111,333 m² për 49 pasuri, nga të cilat për 38 pasuri me sipërfaqe 90,273 m² janë lëshuar certifikata pronësie dhe për 10 pasuri me sipërfaqe 21,060 m² personat nuk janë paraqitur për aplikim në ZVRPP Kuçovë, veprime në papajtueshmëri me nenet 10, 24 dhe 25 të ligjit 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën” dhe me nenet 2, pikat 4, 5, 6 e nenin 3, të ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore” e me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (Trajtuar më hollësisht në faqet 65-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 20/2, volumni 1, faqe 34; nr. 284/10, volumni 1, faqe 192; nr. 284/39, volumni 1, faqe 221; nr. 285/5, volumni 2, faqe 22; nr. 286/5, volumni 2, faqe 37; nr. 359/3, volumni 3, faqe 148; nr. 406/5, volumni 4, faqe 139; nr. 307/21, volumni 2, faqe 202; nr. 329/9, volumni 3 faqe 38; nr. 457/58, volumni 6, faqe 196; nr. 471/1, volumni 7, faqe 23; nr. 488/22, volumni 7, faqe 66; nr. 528/5, volumni 8, faqe 25; nr. 457/24, volumni 6, faqe 162; nr. 501/46, volumni 7, faqe 228; nr. 464/13, volumni 6, faqe 245; nr. 300/25, volumni 2, faqe 141; nr. 415/10, volumni 4, faqe 209; nr. 420/4, volumni 4, faqe 250; nr. 423/18, volumni 5, faqe 26; nr. 447/15, volumni 5, faqe 86; nr. 457/1, volumni 6 faqe 139; nr. 475/74, volumni 6, faqe 212; nr. 300/39, volumni 2, faqe 155; nr. 426/1, volumni 5, faqe 35; nr. 532/4, volumni 8, faqe 43; nr. 544/4, volumni 8, faqe 111; nr. 406/14, volumni 4, faqe 148; nr. 423/13, volumni 5, faqe 21; nr. 456/33, volumni 6, faqe 126; nr. 532/5, volumni 8, faqe 44; nr. 544/1, volumni 8, faqe 108; nr. 457/65, volumni 6, faqe 203; nr. 494/33, volumni 7, faqe 120; nr. 487/1, volumni 7, faqe 32; nr. 457/45, volumni 6, faqe 183; nr. 464/10, volumni 6, faqe 242; nr. 300/46, volumni 2, faqe 162; nr. 457/10, volumni 2, faqe 162; nr. 457/10, volumni 6, faqe 148; nr. 457/51, volumni 6, faqe 189; nr. 467/5, volumni 7, faqe 17; nr. 494/2, volumni 7, faqe 89; nr. 488/17, volumni 7, faqe 61; nr. 487/4, volumni 7, faqe 35; nr. 299/26, volumni 2, faqe 105; nr. 258/13, volumni 1, faqe 138; nr. 284/29/2, volumni 1, nr. 211; nr. 284/31, volumni 1, faqe 213; nr. 386/9, volumni 4, faqe 80; nr. 501/77, volumni 8, faqe 9; nr. 329/47, volumni 8, faqe 176; të ZK 1699, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko- ligjor.

Deri më datë 30.10.2016

2. Gjetje nga auditimi: ZVRPP Kuçovë me Referencën 001053, në ZK 3227, “Rreth-Tapi”, ka pranuar për regjistrim AMTP-të në të cilat është ndërhyrë duke shtuar e mbishkruar shifrat në AMTP për nga një pasuri, dhe tek mbishkrimi “tokë gjithsej” është fshirë shifra ekzistuese dhe është shënuar shifër tjetër, e cila përfshin dhe shifrën e shtesës të pasurisë. Në ZVRPP

Kuçovë nuk ndodhet asnjë shkresë apo autorizim që të konfirmojë hedhjet e pasurive (shitesave) në AMTP-të. Ky veprim është kryer përkatësisht:

Nga 187 pasuri të audituara, në 148 pasuri është shtuar sipërfaqja **prej 72,154 m² tokë Arë**, nga të cilat:

-Janë regjistruar dhe kanë marrë certifikata pronësie për 51 pasuri me sipërfaqen 28,630 m² tokë arë;

-Janë regjistruar në KPP dhe në Librin e Ngastrave (printimi III-të) por nuk janë tërhequr certifikatat e pronësisë për 97 pasuri me sipërfaqen 43,524 m².

Kjo sipërfaqe prej 72,154 m² tokë arë “Arë” e shtuar në AMTP dhe e pa dokumentuar nga Komisionet dhe strukturat përkatëse ligjore **i përket pronësisë “Shtet”**.

Për 148 AMTP, të cilat nuk përmbushin elementët e formës dhe të përmbajtjes, *ZVRPP Kuçovë duhet të mos procedonte me regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikata pronësie, por duhet t'i kërkonte Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KV) pranë Prefektit të Qarkut Berat, vlefshmërinë ligjore të 148 AMTP-ve*

Këto veprime janë në pajtueshmëri me shkronjën “a”, neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shkronjën “ç”, pika 2, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” dhe shkronja “a” pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individ a institucione” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 80-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60 dhe 74 për 148 pasuri me sipërfaqe 72,154 m² sipas AMTP të llojit arë dhe sipërfaqe 71 599 m² sipas LN PIII pra të rezultuara tepër +29764 m² tokë bujqësore, ndarë: për 51 pasuri me sipërfaqe tepër 28,630 m², të regjistruar dhe pajisur me certifikatë pronësie të pajtësuar dhe 97 pasuri të pajisur me certifikatë pronësie, deri në kryerjen e bilancit AMTP-LN dhe të ndjekë zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi” dhe shfuqizimin e certifikatave, kthimin dhe regjistrimin “shtet” të sipërfaqeve tepër për AMTP-të që u përkasin 148 pasurive sipas tabelës në faqet 60-68 të Raportit Përfundimtar.

Deri më datë 30.10.2016

3. Gjetje nga auditimi: Në regjistrimin e AMTP-së nr. 272, datë 16.10.1996, në të cilën Arben Karemani ka në pronësi tokë bujqësore me sipërfaqe 5,000 m², për dy parcela, ndërsa në LN, ka vetëm 1 pasuri me nr. 33/9 e regjistruar në KPP me sipërfaqe 2,000 m² arë.

-Për pasurinë nr. 33/9 e regjistruar në KPP sipërfaqe 2,000 m² arë, nuk është lëshuar certifikatë, por është regjistruar pasuria nr. 333/7, volumni 5, faqe 192, për sipërfaqe 2,900 m² arë, dhe është lëshuar certifikata datë 13.10.2006 e cila nuk figuron në Librin e Ngastrave. Këto veprime janë në pajtueshmëri me pikën a, neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.0.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruarit”(Trajtuar më hollësisht në faqet 75-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë, të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1, neni 49 dhe nenit 59 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 333/7, volumni 5, faqe 192, ZK 3227, *deri në kryerjen e bilancit AMTP-LN dhe të ndjekë zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi”*.

Deri më datë 30.10.2016

4. Gjetje nga auditimi: Në regjistrimin e AMTP-së nr. 9, datë 15.10.1996, ku AMTP-ja, tek mbishkrimi për tokë gjithsej është 8,350 m² dhe i përket 3 zërave kadastralë, e cila është fshirë dhe shënuar 9,150 m² ose 800 m² tokë më tepër, shifër kjo e korrigjuar, duke shtuar në AMTP, pasurinë 4, ”L. Kodër” me sipërfaqe 800 m², nga të cilat 600 m² janë tokë “arë” dhe 200 m² “truall”, pa kufitar. Për pasurinë. 19/14, vol 2, faqe 68, me sipërfaqe 7,007 m² tokë arë, është lëshuar certifikata datë 08.01.2009, regjistruar sipas librit të ngastrës, ndërsa në AMTP është 6,000 m² ose 1,007 m² më pak. Pasuria nr. 14/26, vol 1, faqe 113, në KPP është regjistruar sipërfaqe 2,440 m² nga e cila 200 m² truall sipas LN, ndërsa sipas AMTP-së është 800 m². Nga përlllogaritjet konstatohet se janë regjistruar **1,207 m² tokë** më tepër, për trashëgimtarët e familjes Kullumi.

Sa sipër, AMTP në pronësi të familjes K., nuk përmbushin elementët e formës dhe të përmbajtjes së Aktit Administrativ, veprim në papajtueshmëri me shkronjën “a”, neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shkronjën “ç”, pika 2, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” dhe shkronjën “a”, pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individ a institucione” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 45-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë, të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1, neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 19/14, vol 2, faqe 68; nr. 14/26, vol 1, faqe 113, të ZK 3227, që i përkasin e AMTP-së nr. 9, datë 15.10.1996, si dhe të veçojë e regjistrojë “shtet” sipërfaqen prej **1,207 m² tokë**, të dhënë më tepër për trashëgimtarët e familjes K, për të cilat është lëshuar certifikatë pronësie, deri në verifikimin e kryerjes së bilancit AMTP-LN, në zbatim të VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi”.

Deri më datë 30.10.2016

5. Gjetje nga auditimi: Në regjistrimin e AMTP nr. 123, datë 15.10.1996, ku familja B., ka marrë në pronësi tokë bujqësore me sipërfaqe 10,500 m².

Janë regjistruar pasuritë: nr. 51/5, vol 3, faqe 205, me sipërfaqe 7,920 m² tokë arë, sipas librit të ngastrës, në një kohë që sipas AMTP-së kjo sipërfaqe është 8,000 m².

Pasuria nr. 49/3, vol 3, faqe 177, sipërfaqe 4,550 m² tokë arë sipas LN, ndërsa sipas AMTP-së është 2,000 m². Kjo pasuri ka shkuar në:

- Pasurinë 41/3, volumni 7, faqe 58, me sipërfaqe 2,500 m² dhe nr. 41/1, volumni 7, faqe 59, me sipërfaqe 2000 m², ku është lëshuar certifikata më datë 06.04.2005. KPP është e pa nënshkruar nga specialisti që ka punuar praktikën.

Për pasurinë 51/5 e cila ka shkuar në pasurinë 51/12, 51/13 dhe 51/14, regjistruar në volumin 8, faqe 164, 165 dhe 166 është lëshuar certifikatë.

-Pasuria 49/3 që është shtuar nga persona të tjerë është e regjistruar në volumin 3, faqe 177, sipërfaqja 900 m² dhe për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë.

Nga përlllogaritja dhe nga krahasimi me AMTP rezulton se janë regjistruar në KPP 13,370 m² tokë ose **2,870 m² tokë arë më tepër.**

Sa sipër, AMTP në pronësi të familjes (B), nuk përmbushin elementët e formës dhe të përmbajtjes të Aktit Administrativ, veprim në papajtueshmëri me shkronjën “a”, neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shkronjën “ç”, pika 2, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” dhe shkronjën “a”, pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individ a institucione” (Trajtuar më hollësisht në faqet 55-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë, të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1, neni 49; dhe nenit 59 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 41/3, vol 7, faqe 57; nr. 41/1, vol 7, faqe 59 të ZK 3227, që i përkasin e AMTP-së nr. 123, datë 15.10.1996, si dhe të veçojë e regjistrojë “shtet” sipërfaqen prej **2,870 m² tokë “arë”**, për trashëgimtarët e familjes B, për të cilat është lëshuar certifikatë pronësie, deri në verifikimin e kryerjes së bilancit AMTP-LN, në zbatim të VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi”.

Deri më datë 30.10.2016

6. Gjetje nga auditimi: ZVRPP Kuçovë, ka bërë regjistrimin e AMTP-së nr. 56, datë 16.10.1996, ku konstatohet se: AMTP-ja, tek mbishkrimi për tokë gjithsej është 7,650 m² dhe i përket 5 zërave kadastralë, ndërsa tek shuma në fund është 9,650 m² tokë, shifër kjo që është e korrigjuar tek nr. 2 rendor i AMTP-së, në pasurinë 552 e cila ka qenë 400 m² truall, është shtuar 2,000 m² tokë arë. Po e njëjta shumë është shënuar edhe në fund të kolonës gjithsej. Shuma 7,650 m² i përket 5 zërave kadastralë, në emër të Shyqyri Ibrahimaj e 5 bashkëpronarëve dhe është **regjistruar 950 m² tokë më tepër** se AMTP-ja në pasurinë 556/3, volumi 7, faqe 232, veprim në papajtueshmëri me pikën a, neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.0.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

- ZVRPP Kuçovë, ka bërë regjistrimin e pasurisë, ku pasuria 552, në AMTP, ka qenë 400 m² truall dhe është shtuar 2,000 m² tokë arë, ndërkohë që *duhej t'i kërkonte Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) pranë Prefektit të Qarkut Berat, vlefshmërinë ligjore të AMTP-së*, pasi nuk përmban elementët e formës, veprim në papajtueshmëri me UKM nr. 2, datë 12.09.2012, “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 65-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë, të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pika 1, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë 556/3,

volumi 7, faqe 232, të ZK 2179, që i përkasin e AMTP-së nr. 56, datë 16.10.1996, si dhe të veçojë e regjistrojë “shtet” sipërfaqen tepër prej **950 m² tokë “arë”**, për të cilat është lëshuar certifikatë pronësie, deri në verifikimin e kryerjes së bilancit AMTP-LN, në zbatim të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi”.

Deri më datë 30.11.2016

7. Gjetje nga auditimi: ZVRPP Kuçovë në 12 raste, ka bërë regjistrimin e pasurisë në mungesë të urdhrit të Regjistruesit dhe në mungesë të kërkesës me shkrim të pronarit, veprime në papajtueshmëri me nenin 34, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- ZVRPP Kuçovë në 10 raste, nuk ka përgatitur kopje e hartës tregues të regjistrimit (HTR), *ku të përcaktojë me vijëzim me ngjyre të kuqe pozicionin gjeografik të pasurisë*, veprim në papajtueshmëri me pikën 10.6, Kreu i II, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 80-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5; pika 1, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 508/14, volum 3, faqe 17; nr. 508/25, volum 3, faqe 723; volumi 5, faqe 89; nr. 570/3, volumi 9, faqe 124; nr. 512/8, volum 9, faqe 109; nr. 629/10, volum 9, faqe 102; nr. 143/8, volum 2, faqe 70; nr. 754/65, volum 9, faqe 91; nr. 23/4, volum 1, faqe 54; nr. 508/14, volum 3, faqe 17, të ZK. 2179, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Deri më datë 30.10.2016

8. Gjetje nga auditimi: ZVRPPP Kuçovë ka lëshuar certifikata pronësie për pasuritë nr. 723/22, volum 5, faqe 89 dhe nr. 512/8, volum 9, faqe 109, të ZK. 2179. ndërsa në Kartelat e Pasurisë së Paluajtshme (KPP) është vendosur vula e ZVRPP, por *janë pa nënshkrimin e specialistit dhe Regjistruesit*, veprim në papajtueshmëri me pikën 8, Seksioni II, të Udhëzimit Metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelave të pasurive të paluajtshme” dhe me pikën 10.6, Kreu i II, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 80-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të verifikojë vërtetësinë e dokumentacionit të lëshuar dhe disponuar nga mbajtësi i titullit të pronësisë, për pasuritë nr. 723/22, volum 5, faqe 89 dhe nr. 512/8, volum 9, faqe 109, të ZK. 2179.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në regjistrimin e AMTP nr. 226, datë 06.11.1998, ku konstatohet se në AMTP mungon firma e Kryetarit të Komisionit të Tokës në fshat, e Përfaqësuesit të Rrethit dhe vetë poseduesit të AMTP-së. Ky akt ka vetëm një vulë nga Komuna Perondi dhe zëri kadastral “Gropa e Njojut”, me sipërfaqe 300 m² “truall”, është pa kufitar.

Sa më sipër, AMTP në pronësi të familjes M, nuk përmbush elementët e formës dhe të përmbajtjes së Aktit Administrativ, veprim në papajtueshmëri me pikën 5, neni 45, të ligjit nr. 33, datë 21.0.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për

përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 80-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1, neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 23/4, volumi 1, faqe 54; nr. 508/14, volum 3, faqe 17 dhe nr. 508/25, volum 3, faqe 18, të ZK 2179, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Deri më datë 30.11.2016

10. Gjetje nga auditimi: Në regjistrimin e AMTP-së nr. 18, datë 15.10.1996, ku familja Gj. ka marrë në pronësi tokë bujqësore me sipërfaqe 11,700 m², që është fshirë dhe shënuar 11,200 m², pra ka përfituar **500 m² tokë më tepër**. Shifra është e korrigjuar, duke shtuar në AMTP, pasurinë 43 ”L. Qendër” me sipërfaqe 500 m², nga e cila 300 m² arë dhe 200 m² truall.

ZVRPP Kuçovë ka bërë regjistrimin duke lëshuar certifikatë për pasurinë: Nr. 143/9, vol 5, faqe 161, sipërfaqe 360 m², tokë arë + truall, nga e cila 200 m² truall dhe 60 m² ndërtesë, certifikata datë 02.08.2007. Në listat emërore të pronarëve të trojeve të fshatit “Rreth – Tapi” rezulton 200 m² truall dhe nga kjo 60 m² ndërtesë, pra është kryer regjistrimi për 360 m² tokë ose **160 m² më tepër**, ku nga Lista emërore e Pronarëve konstatohet se është e pa justifikuar, në kundërshtim me pikën 12.1, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 ”Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, për pasuritë e paluajtshme të fituara në bazë të ligjeve të urbanistikës, në vartësi të viteve dhe të ndarjes administrative qytet/fshat për ndërtimet e kryera para vitit 1990 në fshat. Baza ligjore është Dekreti nr. 5747, datë 29.06.1978, ku në nenin 10, përcaktohet: “Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore është në “përdorim” një ngastër deri në 200 m² në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 m² dhe në qytete, sipas rastit, 140 deri 170 m² (*Trajtuar më hollësisht në faqet 60-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë, të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5; pika 1, neni 49 dhe nenit 59 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 143/9, vol 5, faqe 161, të ZK 3227, deri në verifikimin e kryerjes së bilancit AMTP-LN, në zbatim të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi”.

Deri më datë 30.10.2016

11. Gjetje nga auditimi: ZVRPP Kuçovë, ka regjistruar pasurinë nr. 9/535, volumi 28 faqe 83, për objektin: “Lokal Shërbimi 2 Kat”, sipas lejes së ndërtimit Nr. 35, datë 24.08.2006, me sipërfaqe ndërtimi 188 m², nga firma zbatuese “L.....” me përfaqësues D.A, me mangësi në dokumentacion:

Kërkesa për, shesh ndërtimi është pa datë dhe është e një periudhe më të hershme se ajo e miratimit të lejes së ndërtimit (formatit të kërkesave të miratuara në bazë të ligjit 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”).

-Vendimi i Sheshit të Ndërtimit nr. 45, datë 18.07.1996, me sipërfaqe 130 m², firmosur nga Kryetari Këshillit të Bashkisë.

-Leja e ndërtimit nr. 35 datë 24.08.2006, me sipërfaqe 188 m².

Nga krahasimi midis vendimit të miratimit të sheshit të ndërtimit me sipërfaqe 130 m² dhe lejes së ndërtimit me 188 m², rezulton një diferencë sipërfaqe **ndërtimi 58 m² më tepër**.

Vendimi për dhënien e sheshit të ndërtimit është i pa vulosur nga personi përgjegjës, Kryetari i Këshillit të Bashkise. Planimetria e sheshit të ndërtimit është e hartuar më vonë nga data e daljes së vendimit për dhënie sheshi ndërtimi (*duhet përgatitur njëherë plan vendosja e sheshit të ndërtimit dhe me pas te dalë vendimi*).

-Mungojnë planimetritë e kateve, mungon projekti i miratuar.

-Proces verbali kolaudimit datë 20.08.2007 i mbajtur nga ing. G.A me licencën nr. K. Z-0555. Në rubrikën sheshi i ndërtimit nuk është përcaktuar sipërfaqja e strukturës ndërtimore, veprim në papajtueshmëri me pikën 1, neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012, “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 45-150, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë, të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1, neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 9/535, volumni 28, faqe 83, të ZK 2310, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Deri më datë 30.11.2016

12. Gjetje nga auditimi: ZVRPP Kuçovë, ka regjistruar pasurinë nr. 8/74, volumni 27, faqe 116, për objektin: “Lokal shërbimi 2 kate”, sipas lejes së ndërtimit Nr. 35, datë 24.08.2006, me sipërfaqe ndërtimi 188 m², firma zbatuese “L.....” me përfaqësues D.A. me mangësi në dokumentacion:

Kërkesa për shesh ndërtimi është pa datë dhe është e një periudhe më të hershme se ajo e miratimit të lejes së ndërtimit (formatit të kërkesave të miratuara në bazë të ligjit 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”).

-Vendimi i sheshit të ndërtimit nr. 2, datë 07.09.1999, me sipërfaqe 98 m², firmosur nga Kryetari Këshillit të Bashkisë, rezulton pa vullë.

-Leja e ndërtimit nr. 4, datë 09.04.2009, rezulton me sipërfaqe 140 m² *ose 42 m² më shume se leja për sheshin e ndërtimit.*

-Në dosje mungojnë:

-Plan vendosja e sheshit të ndërtimit.

-Planimetritë janë fotokopje të pa noterizuara.

-Proces verbali kolaudimit është pa datë, i mbajtur nga ing. L. N. me licensë nr. K. 0543/2.

-Mungon marrëdhënia me truallin, veprim në papajtueshmëri me pikën 1, neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012, “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 45-152, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë, të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1, neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 8/74, volumni 27, faqe 116, të ZK 2310, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Deri më datë 30.10.2016

13. Gjetje nga auditimi: ZVRPP Kuçovë, ka regjistruar pasurinë nr. 3/4, volumi 29, faqe 18, për objektin: “Lokal shërbimi 2 kate” dhe banesën e ndodhur në lagjen “11 janari”, sipas lejes së ndërtimit Nr. 54, datë 30.04.1998, me sipërfaqe ndërtimi 130 m², me mangësi në dokumentacion:
- Projekti, planimetri kati, akt-kolaudim, janë të pa vulosur si dhe mungon marrëdhënia e pronësisë mbi truallin.

-Vendimi i dhënies së sheshit të ndërtimit është fotokopje e pa noterizuar.

-Plani i sheshit të ndërtimit është i pa miratuar nga kryetari KRRT, veprime në papajtueshmëri me pikën 1, neni 46 dhe pikën 1, neni 70, të ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

-Pasuria nr. 3/4 është regjistruar në mungesë të titullit të pronësisë, veprime në papajtueshmëri me nenin 25, germa “a” dhe nenin 193, të “Kodit Civil” Mbi përcaktimin e titujve të pronësisë të detyrueshëm për regjistrim” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 80-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1, neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. nr. 3/4, në volumin 29, faqe 18, të ZK 2310, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Deri më datë 30.11.2016

14. Gjetje nga auditimi: ZVRPP Kuçovë, ka regjistruar pasurinë nr. 4/162, volumi 29, faqe 109, për objektin: “Dyqan” në lagjen “T. S.”, me mangësi në dokumentacion:

-Pasuria nr. 4/162, është regjistruar në bazë të vendimit të gjykatës nr. 303 datë 15.03.1996, plan rilevimi, leje ndërtimi.

Pasuria me nr. 4/162 figuronte e regjistruar në regjistrat hipotekor dhe akti me të cilin është regjistruar, (Vendim Gjykatë nr. 303 datë 15.03.1996), është vërtetim fakti juridik dhe si i tillë neni 193, i “Kodit Civil” paragrafi i fundit, parashikon se “Vërtetimi i faktit nuk regjistrohet”, pra nuk është titull pronësie.

-Leja e ndërtimit nr. 314, datë 29.11.1996. Sheshi i ndërtimit është miratuar me vendimin nr. 260 datë 11.09.1995.

-Dosja me lejen e ndërtimit dhe sheshin e ndërtimit ka mangësi, në projekt, planimetri kati, akt kolaudim si dhe në mungesë të marrëdhënieve me truallin.

-Me anë të aplikimit nr. 63, datë 22.01.2013, është kryer regjistrimi i vendimit të gjykatës me nr. 55, datë 18.12.2012 për ndreqjen e gabimeve në vendimin civil me nr. 303, datë 15.03.1996.

-Me anë të aplikimit nr. 135, datë 18.03.2013, është kryer regjistrimi i kontratës së shitjes për truallin nën objekt me palë shitëse DAPP.

Pasuria nr. 4/162 është regjistruar në mungesë të titullit të pronësisë, veprime në papajtueshmëri me nenin 25, germa “a” dhe me shkronjën “h”, të nenit 193, paragrafi i fundit.

Regjistrimi i pasurisë është kryer në papërputhshmëri me pikën 12, të Rregullores për punën në zyrat e regjistrimit me nr. 184 datë 08.04.1999 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 45-154, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë, të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 4/162, volumi 29, faqe 109, të ZK 2310, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Deri më datë 30.10.2016

15. Gjetje nga auditimi: ZVRPP Kuçovë në 48 raste, në ZK 1611, Komuna F, Kuçovë me sipërfaqe të përgjithshme 810650 m² sipas AMTP tokë bujqësore arë, ka bërë regjistrimin e pasurive të paluajtshme me sipërfaqe 819481 m² sipas LN, ku konstatohet diferenca në sipërfaqe 8831 m² ndërmjet LN (Librit të ngastrave Prill 1996) dhe Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP), ndërsa sipërfaqen e tepërt duhej ta veçonte e t`a regjistronte në pronësi shtet, veprim në pajtueshmëri me shkronjën “a”, neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.0.2012, ”Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 28-29, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për 48 pasuritë me sipërfaqe sipas AMTP-së 810650 m² dhe sipas LN (printim III) 819481 m² ose 8831 m² sipërfaqe tepër tokë bujqësore, të ndodhura në ZK 1611, Komuna F, Kuçovë, deri në veçimin e sipërfaqes tepër dhe regjistrimin “shtet” në KPP-të .

Deri më datë 30.12.2016

16. Në ZVRPP Kuçovë, në ZK 3561, Fshati T, nga auditimi i 50 pasurive me sipërfaqe 110,460 m², sipas AMTP-ve të llojit arë, truall dhe pemëtore konstatohet sipërfaqe e regjistruar **117411 m²**. Ky regjistrim është bazuar në LN PIII, pra rezultojnë tepër + **6951 m²** tokë bujqësore, për të cilat nuk është bërë bilanci AMTP-LN PIII, duke mos veçuar e regjistruar “Shtet” sipërfaqen tepër. Janë lëshuar certifikata për 21 pasuri me sipërfaqe *tepër* + 3165 m², prej të cilave: 6 pasuri me sipërfaqe tepër +1393 m² në vitet 2014-2015 dhe 15 pasuri me sipërfaqe tepër +1772 m² para vitit 2014; veprime këto të kryera në kundërshtim me Ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me nenin 25 të Ligjit nr. 33, datë 21.3.2012, pasqyruar në tabelën emërtuar “Lëshim certifikata mbi normë amtp toke arë dhe Truall, ZK.3561, Tapi, ZVRPP Kuçovë (*Trajtuar hollësisht në faqet 65-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të Ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012 ”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74 **për 21 pasuri me sipërfaqe tepër 3165 m²** dhe konkretisht pasuritë: nr. 1239/7, 1309/83, nr. 1309/84, 1319/4, 1493/7, 1497/1, 1497/7, 1275/41, 1302/6, 1308/9, 1226/8, 1271/6, 1316/11, 1314/42, 1346/99,1345/115, 1345/32, 1316/12, 1316/11, 1229/11, 2338/27, ZK. 3561, të cilat rezultojnë me sipërfaqe 52,590 m² sipas AMTP-ve të llojit arë dhe truall dhe sipërfaqe 55,755 m² sipas LN PIII, pra të rezultuara tepër +3165 m², regjistruar dhe pajisur mbajtësit me certifikatë pronësie të cilat nuk janë tjetërsuar, mbetur gjendje tek mbajtësi i parë, deri në kryerjen e bilancit AMTP-LN dhe zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi” si dhe deri në kthimin dhe regjistrimin “shtet” të sipërfaqeve tepër, pasqyruar në tabelën emërtuar “Lëshim certifikata mbi normë AMTP toke arë dhe truall, ZK. 3561, Tapi, ZVRPP Kuçovë”.

Deri më datë 30.11.2016

17. Në ZVRPP Kuçovë, në ZK 3561, Fshati T, në 30 raste, AMTP-të nuk plotësojnë elementet e formës dhe të përmbajtjes së Aktit Administrativ, prej të cilave konstatohen korrigjime të dokumentacionit në 7 AMTP, nuk janë përcaktuar kufizimet e pasurive në 19 AMTP dhe mungesë të nënshkrimeve nga përfaqësuesi i Rrethit, Kryetari i Komisionit të Tokës dhe pa vulë në 4 raste, veprime dhe mosveprime në pajtueshmëri me pikën 5, të UKM nr. 2, datë

12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit (Trajtuar hollësisht në faqet 45-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.Rekomandimi: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë të marrë masa për nxjerrjen e urdhër kufizimit për 30 AMTP, sipas pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe të dërgohen AMTP nr. 3, 42, 54, 69, 77, 79, 121, 139, 141, 151, 155, 164, 206, 184, 212, 228, 248, 259, 301, 358, 389, 390, 391, 404, 405, 364, 356, 350, 325, 310, gjithsej 30 AMTP, për verifikimin e statusit ligjor të titujve të pronësisë, Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KV) pranë Prefektit të Qarkut Berat dhe Bashkisë Kuçovë, në zbatim të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 pika 2.2, shkronja “ç”.

Deri më datë 30.10.2016

18. ZVRPP Kuçovë në ZK 2257, K, nga auditimi i 132 pasurive (52 pasuri volumi 1 dhe 80 pasuri volumi 2), me sipërfaqe 281010 m², sipas AMTP-ve të llojit arë, truall dhe pemëtore dhe sipërfaqe e regjistruar 427,469 m² sipas LN P.III, pra të rezultuara tepër + 146,459 m² tokë bujqësore, për të cilat nuk është bërë bilanci AMTP-LN P.III, duke mos veçuar e regjistruar “Shtet” sipërfaqen tepër dhe lëshuar certifikata për 65 pasuri me sipërfaqe *tepër* + 76650 m², prej të cilave: 6 pasuri me sipërfaqe tepër +11013 m² në vitet 2014-2015 dhe 59 pasuri me sipërfaqe tepër +65637 m² para vitit 2014, veprime këto të kryera nga personat e përcaktuar në tabelën e emërtuar “Tabela me të dhënat e regjistrimeve sipas AMTP dhe LN, ZK 2257, fshati K, volumi I, Volumi II”, në kundërshtim me Ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me nenin 25 të Ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 (Trajtuar hollësisht në faqet 75-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë, të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të Ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012 ”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60, 74 për 65 pasuri me sipërfaqe 281,010 m² sipas AMTP-ve të llojit arë dhe truall dhe sipërfaqe 427,469 m² sipas LN P.III dhe të rezultuara tepër +76650 m², konkretisht pasuritë e regjistruar në KPP: **Vol I**, f. 6, 30, 94, 96, 105, 106, 107, 144, 148, 149, 150, 152, 164, 169, 183, 185, 200, 214, 230, 234, 239, 244.

Vol.II f.:12, 13, 15, 20, 27, 58, 67, 69, 75, 88, 106, 114, 133, 137, 139, 140, 142, 144, 145, 153, 154, 159, 164, 168, 169, 170, 171, 180, 182, 183, 186, 188, 189, 196, 211, 214, 215, 220, 224, 247, 250, pasuri të cilat janë regjistruar dhe pajisur mbajtësit me certifikatë pronësie dhe që nuk janë tjetërsuar (mbetur gjendje tek mbajtësi i parë), **deri në kryerjen e bilancit** AMTP-LN dhe zbatimin e procedurave sipas VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi” si dhe deri kthimin dhe regjistrimin “shtet” të sipërfaqeve tepër, pasqyruar në tabelën emërtuar “Tabela me të dhënat e regjistrimeve sipas AMTP dhe LN, ZK 2257, fshati Kozarë, volumi I, Volumi II”.

Deri më datë 30.10.2016

19. Gjetje: ZVRPP Kuçovë në ZK 2257, Fshati Kozarë, në 143 AMTP, për sipërfaqen 117210 m², AMTP-të nuk plotësojnë elementet e formës dhe të përmbajtjes së Aktit Administrativ, në sipërfaqe toke të llojit “Ullishte” prej të cilave konstatohet se *nuk janë përcaktuar kufizimet e pasurive në 143 AMTP*, veprime dhe mosveprime në papajtueshmëri me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit

të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit (Trajtuar hollësisht në faqet 60-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19. Rekomandimi: Nga ZVRPP Kuçovë të merren masa për nxjerrjen e urdhër kufizimit për 143 AMTP për sipërfaqen 117210 m², sipas pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe t'i dërgohen AMTP nr.:1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 92, 903, 94, 95, 97, 98, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 109, 110, 111, 112, 113, 114, 115, 116, 117, 118, 119, 120, 121, 122, 123, 124, 125, 126, 127, 131, 132, 133, 134, 135, 136, 137, 138, 139, 140, 142, 143, 144, 145, 146, 147, 148, 149, gjithsej 143 AMTP, për verifikimin e statusit ligjor të titujve të pronësisë, Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KV) pranë Prefektit të Qarkut Berat dhe Bashkisë Kuçovë në zbatim të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 pika 2.2, shkronja “ç”.

Brenda muajit Nëntor 2016

20. Gjetje nga auditimi: ZVRPP Kuçovë, në tre raste, AMTP nr. 99, datë 30.03.1002 për pronat e qytetarit N. C.D, AMTP nr. 1021, datë 30.03.1992 për pronat e qytetarit Sh. D dhe AMTP nr. 96, datë 30.03.1992 për pronat e pronarit H.D, akti i marrjes së pronësisë nuk është firmosur nga përfaqësuesi i rrethit Berat F.M. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2 datë 13.06.2013. pika 2.1, germa b, “Kur gjatë verifikimit rezulton se regjistrimi ka mangësi apo është kryer në kundërshtim me ligjin, konstatimet e kryera nga punonjësit, që përpunojnë praktika, i referohen regjistruarit në formë të shkruar, duke treguar hollësisht mangësitë e konstatuara (Trajtuar më hollësisht në faqet 55-150, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20. Rekomandim: Regjistruari i ZVRPP Kuçovë, të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59 i ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të regjistrimit të pasurive të AMTP 99, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 5/16, volumni 1, faqe 52; nr.12/5, volumni 1, faqe 82; nr. 11/11, volumni 1, faqe 28; nr. 12/16, volumni 1/98, faqe 22; AMTP nr 1021 për pasuritë 16/14, volumni 1, faqe 119; nr. 16/16, volumni 1, faqe 120; nr. 17/1, volumni 1, faqe 127; nr. 28/2, volumni 1, faqe 127; nr. 28/2, volumni 1 faqe 177; nr. 28/10, volumni 1, faqe 185, pasuritë me AMTP nr 96, nr.12/3, vol 1 faqe 85, nr. 11/9, volumni 1, faqe 76. Për sa sipër, ZVRPP Kuçovë, ti kërkojë Komisionit vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë (KV) pranë Prefektit të Qarkut Berat, vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 99, 96 dhe 1021 (Trajtuar më hollësisht në faqet 80-120, të Projekt Raportit të Auditimit).

Deri më datë 30.11.2016

21. Gjetje nga auditimi: Në ZVRPP Kuçovë, aplikuesit për regjistrimin e pasurive në zonat kadastrale ZK nr. 3798 fshati V, ZK nr. 3723 fshati V, ZK nr. 2548 fshati M, në dokumentacionit tekniko ligjor konstatohet se në asnjë rast në dosje nuk ndodhet kërkesa me shkrim e pronarit (fletë aplikimi), veprim në papajtueshmëri me nenin 34, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ku përcaktohet: ”Me kërkesën me shkrim të pronarit të vetëm, regjistruari bën regjistrimin (Trajtuar hollësisht në faqet 58-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.Rekomandim: ZRPP Kuçovë të marrë masa të menjëhershme që në çdo rast aplikimi nga qytetarët të plotësohet kërkesa prej tyre në përputhje me kerkesat ligjit 33, datë 21.03.2012.

Në vazhdimësi

22. Gjetje nga auditimi: ZVRPP Kuçovë, bazuar në AMTP nr 12, datë 07.02.1993, të qytetarit F. K. ZK 2548, Fshati Majgjataj, ka regjistruar pasurinë nr. 500/67, vol 2 faqe 92, gjendja e të cilë sipas Printim III AMPT “ është zero m²” dhe është regjistruar në KPP 1925 m² sipas plan rilevimit.

22. Rekomandim:ZVRPP Kuçovë, të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59 i ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në mangësitë e PIII në hedhjen e AMTP nr.12, datë 7.02.1992, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr.500/67, vol 2 faqe 92 dhe të bëjë bilancin e pasurive AMTP –LN PIII si dhe të kërkojë pranë Komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë (KV) pranë Prefektit të Qarkut Berat, vlefshmërinë ligjore të AMTP nr 12, datë 07.02.1993 (*Trajtuar hollësisht në faqet 58-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: ZRPP Kuçovë bazuar në Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 18, datë 30.04.1993 lëshuar në favor të qytetarit E.M, për sipërfaqen totale 8670 m² ka regjistruar në fakt sipas rilevimit 8720 m² më shumë 50 m² (*Trajtuar hollësisht në faqet 58-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

23.Rekomandim:ZVRPP Kuçovë, të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59 i ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të regjistrimit të pasurive të AMTP 18 datë 30.04,1992, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë dhe të bëjë menjëherë sistemimin e sipërfaqes 50 m² duke e regjistruar pronë “shtet”.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetje nga auditimi: Nga ZVRPP Kuçovë në 1 rast, nuk ka llogaritur dhe arkëtuar kamatë vonesa për regjistrimin e objektit, referuar lejes së shfrytëzimit të objektit “Rikonstruksion dhe shtesë kati me investitor I.L”, e cila autorizon ZRPP të bëjë regjistrimin e pasurisë së mësipërme. Ky dokumentacion është dërguar për regjistrim me 274 ditë vonesë gjë për të cilën aplikuesi në zbatim të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” nenit Neni 39, Vonesa e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim “Nëse një kërkesë për regjistrim, sipas nenit 38 të këtij ligji, paraqitet më vonë se 30 ditë nga data e realizimit të tij, përveç tarifës së regjistrimit, për çdo ditë vonesë, që ka kaluar nga kjo datë, paguhet kamatëvonesa, e barabartë me 10 për qind të tarifës së regjistrimit, por jo më shumë se 300 000 lekë. Subjekti duhet të paguante kamatë vonesa në shumën 230,160 lekë (274 ditë x 840).Për veprimet e mos veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi ish punonjësja L.T dhe regjistruesi K. B.

1. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë, të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë nr. 7/168

a-2 vol 13, faqe 6 dhe të kërkohet në rrugë ligjore nga investitori i objektit I.LI, arkëtimi i shumës 230,160 lekë (*Trajtuar hollësisht në faqet 58-140, Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Deri më datë 30.11.2016

2. Gjetje nga auditimi: ZVRPP Kuçovë, në aplikimin për regjistrimin e pasurisë nr. 4/162 në volumn 29 faqe 109, nuk ka llogaritur dhe arkëtuar *kamatëvonesa në shumën 300.000 lekë për regjistrim të vonuar që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit*, veprim në papajtueshmëri me neni 39, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2013, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 80-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë, të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurin nr. 4/162 në volumn 29 faqe 109 dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës **300.000 lekë**, nga poseduesit e pasurisë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: ZVRPP Kuçovë në aplikimin për regjistrimin e pasurisë nr. 3/4 në vol. 29 faqe. 18 nuk ka llogaritur dhe arkëtuar *kamatëvonesa në shumën 65,700 lekë llogaritur 365 dite vonesë x 180 = 65,700 lekë, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit*, veprim në papajtueshmëri me nenin 39, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2013 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 55-150, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3. Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Kuçovë, të marrë masa, që në bazë të pikës 1, neni 5, pika 1, neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 3/4 në vol. 29 faqe. 18 dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i shumës **65,700 lekë** nga poseduesit e pasurisë.

Deri më datë 30.10.2016

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, dhe në ligjin nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, si dhe në kontratën individuale të punës, **t’i kërkohet Kryeregjistruesit ZQRPP Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masës disiplinore nga **“Vërejtje”** deri në **“Largim nga puna”**, për punonjësin:

1. M.Xh, me detyrë Jurist, pasi:

-Në **Referencën** 002184, ka bërë regjistrimin e pasurisë në mungesë të urdhrit të Regjistruesit dhe në mungesë të kërkesës me shkrim të pronarit, veprim në papajtueshmëri me nenin 34, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- Në **10 raste**, nuk janë përgatitur kopje e hartës tregues të regjistrimit (HTR) *ku të përcaktoj me vijëzim me ngjyre të kuqe pozicionin gjeografik të pasurisë*, veprim në papajtueshmëri me pikën

10.6, Kreu i II, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 80-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Në **ZK 2257, Kozarë**, nga auditimi mbi 131 pasuri (51 pasuri volumi 1 dhe 80 pasuri volumi 2), me sipërfaqe 281010 m², sipas AMTP-ve të llojit arë, truall dhe pemëtore dhe sipërfaqe e regjistruar 427,469 m² sipas LN P.III, pra të rezultuara tepër + 146,459 m² tokë bujqësore, për të cilat nuk është bërë bilanci AMTP-LN P.III, duke mos veçuar e regjistruar “Shtet” sipërfaqen tepër, janë lëshuar certifikata për *63 pasuri me sipërfaqe tepër + 76,650 m²*, prej të cilave *specialisti M Xh 2013-2015 për 4 pasuri me sipërfaqe tepër 4,185 m²*; në kundërshtim me Ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me nenin 25 të Ligjit nr. 33, datë 21.3.2012, pasqyruar në tabelën emërtuar “Lëshim certifikata mbi normë AMTP toke arë dhe Truall, ZK.3561, Tapi, ZVRPP Kuçovë” (*Trajtuar hollësisht në faqet 75-140, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Masa “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për punonjësin:

1. V. M. me detyrë hartograf, pasi:

-Me AMTP nr. 204, në ZK. 1699 (fshati Gegë), ka kryer veprime për regjistrimin e pasurive me titull pronësie në **përdorim, me sipërfaqe 9940 m² për 3 pasuri dhe ka lëshuar certifikatë pronësie, në të cilat mungon fletë aplikimi në dokumentacion**, veprim në papajtueshmëri me nenin 10, 24 dhe 25 të ligjit 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën” dhe me nenin 2, pikat 4, 5, 6 dhe neni 3, të ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore” dhe me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruarit” (*trajtuar më hollësisht në faqet 65-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Në **5 raste**, përkatësisht në referencat nr. 002149, 002183, 002184, 002163, 002157, ka kryer veprime për regjistrimin e pasurive me sipas AMTP-ve, në të cilat është ndërhyrë nga persona të tjerë duke shtuar në çdo AMTP nga një pasuri ku në secilën prej tyre, tek mbishkrimi “tokë gjithsej” është fshirë dhe shënuar shifër tjetër, duke përfshirë dhe shifrën e pasurisë shtesë.

- Me Referencën 001053, në ZK 3227, “Rreth-Tapi”, ka kryer veprime për regjistrimin e pasurive me AMTP-të në të cilat është ndërhyrë duke shtuar e mbishkruar shifrat në AMTP për nga një pasuri dhe tek mbishkrimi “tokë gjithsej” është fshirë shifra ekzistuese dhe është shënuar shifër tjetër, e cila përfshin dhe shifrën e shtesës të pasurisë. Ky veprim është kryer përkatësisht:

Nga 187 pasuri të audituara, në 148 pasuri është shtuar sipërfaqja **prej 72,154 m² tokë Arë**. Kjo sipërfaqe prej 72,154 m² tokë arë “Arë” e shtuar në AMTP dhe e pa dokumentuar nga Komisionet dhe strukturat përkatëse ligjore i përket pronësisë “Shtet”.

- Për 148 AMTP, të cilat nuk përmbushin elementët e formës dhe të përmbajtjes, *ZVRPP Kuçovë ka proceduar me regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe ka lëshuar certifikata pronësie, pa kërkuar në Komisionin Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KV) pranë Prefektit të Qarkut Berat, vlefshmerinë ligjore të 148 AMTP-ve.*

Këto veprime janë në papajtueshmëri me shkronjën “a”, neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shkronjën “ç”, pika 2, të UKM nr. 2, datë

13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” dhe shkronja “a” pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individ a institucione” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 80-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Ka bërë regjistrimin e AMTP -së nr. 9 datë 15.10.1996, ku është regjistruar **pasuri me sipërfaqe 1,207 m² tokë** më tepër, për trashëgimtarët e familjes K., veprim në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, shkronjën “ç” pika 2, të UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” dhe shkronja “a” pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individ a institucione.

-Ka kryer veprime për regjistrimin e pasurisë me AMTP nr. 56 datë 16.10.1996, ku është **regjistruar 950 m² tokë më tepër nga AMTP-ja** në pasurinë 556/3 volumi 7 faqe 232, veprim në papajtueshmëri me pikën a, nenin 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”.

- Në **Referencën 002149**, ka lejuar regjistrimin e pasurisë në mungesë të kërkesës me shkrim të pronarit, veprim në papajtueshmëri me nenin 34, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

- ZVRPP Kuçovë në **10 raste**, ka kryer veprime për regjistrimin e pasurive me mungesë të kopjes së hartës tregues të regjistrimit (HTR) *ku të përcaktoj me vijëzim me ngjyre të kuqe pozicionin gjeografik të pasurisë*, veprim në papajtueshmëri me pikën 10.6, Kreu i II, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 80-130, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Në **ZK 3561, Fshati Tapi**, nga auditimi është konstatuar se janë lëshuar certifikata pronësie dhe tjetërsuar për **6 pasuri** me sipërfaqe tepër **929 m² të llojit arë, truall dhe pemëto**re pa bërë bilancin AMTP-LN PIII dhe duke mos veçuar e regjistruar “Shtet” sipërfaqen tepër, veprime këto të kryera në kundërshtim me Ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me nenin 25 të Ligjit nr. 33, datë 21.3.2012.

-Në **ZK 3561, Fshati Tapi**, në **30 raste**, AMTP-të nuk plotësojnë elementet e formës dhe të përmbajtjes së Aktit Administrativ, prej të cilave konstatohen korrigjime të dokumentacionit në 7 AMTP, nuk janë përcaktuar kufizimet e pasurive në 19 raste, ka mungesë të nënshkrimeve nga përfaqësuesi i Rrethit, Kryetari i Komisionit të Tokës dhe pa vulë në 4 raste, veprime dhe mosveprime në papajtueshmëri me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit”. Për këto AMTP nuk është kërkuar verifikimi i vlerësimit të titujve të pronësisë pranë KVVTP-së.

-Në **ZK 2257, Fshati Kozarë**, në **143 AMTP**, për **sipërfaqen 117210 m²**, AMTP-të nuk plotësojnë elementet e formës dhe të përmbajtjes së Aktit Administrativ, në sipërfaqe toke të

llojit “Ullishte” prej të cilave konstatohet se *nuk janë përcaktuar kufizimet e pasurive*, veprime dhe mosveprime në papajtueshmëri me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit. Për këto AMTP nuk është kërkuar verifikimi i vlerësimit të titujve të pronësisë pranë KVVTP-së.

-Ka kryer veprime për regjistrimin e pasurive kur në Kartelat e Pasurisë së Paluajtshme (KPP) është vendosur vula e ZVRPP-së, por janë pa nënshkrimin e specialistit dhe Regjistruarit, veprim në papajtueshmëri me pikën 8, Seksioni II, të Udhëzimit Metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelave të pasurive të paluajtshme” dhe me pikën 10.6, Kreu i II, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

PËR PUNONJËSIT E LARGUAR DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL.

I. Për ish drejtuesit dhe ish punonjësit nuk rekomandojmë masa disiplinore. Masa disiplinore e propozuar nga ana jonë, në bazë të shkeljeve të konstatuara, do të ishte “**Ndërprerje të marrëdhënieve të punës**”, përkatësisht për:

1. E.M, ish-Regjistruar deri më 15.07.2002
2. M.M, ish-regjistruar deri më 21.05.2006
3. K.B, ish-Regjistruar deri me 10.10.2013
4. K.M, regjistruar deri më 11.07.2004
5. P.T, ish-regjistruar dhe ish-specialist Hartograf, deri më 24.12.2013
6. L.T,ish-specialiste, juriste deri më 24.12.2013
7. M.M, specialiste Hartografe, deri më 01.07.2015
8. D.G, specialist Hartograf, deri më datën 24.12.2013

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, në ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012, sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, për personat si më poshtë:

1. K. B. me detyrë ish-Regjistruar,
2. V. M. me detyrë Specialist hartograf,
3. D. G. me detyrë ish-Specialist hartograf,
4. P. T. me detyrë ish-Specialist hartograf,
5. M. M. me detyrë ish-Specialist hartograf dhe
6. E. C. me detyrë ish-Specialist jurist,

të cilët në mospërbushje të rregullt të detyrës së tyre funksionale kanë konsumuar elementët e figurës së veprave penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, duke dëmtuar rëndë interesat e ligjshme të Shtetit dhe favorizuar subjektet e ndryshme private (pa përjashtuar këtu edhe mundësinë e konstatimit gjatë hetimeve të përgjegjësisë penale edhe

ndaj personave të tjerë që janë angazhuar në praktikat e sipërcituara dhe që evidentohen më konkretisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar” i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R